



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
DREJTORIA E INFRASTRUKTURËS DHE INVESTIMEVE PUBLIKE

Nr. 5707/2 prot.

Vlorë, më 24.03.2026

PROJEKTVENDIM

Nr. _____ datë ____ . ____ 2026

PËR MIRATIMIN E DEKLARATËS PËR BASHKËFINANCIM DREJTUAR MINISTRISË SË EKONOMISË DHE INOVACIONIT PËR PROGRAMIN “PËRMIRËSIMI I KUSHTEVE TË BANIMIT PËR KOMUNITETE TË VARFËRA DHE TË PAFAVORIZUARA”

Këshilli i Bashkisë Vlorë, në mbështetje të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8 pika 1 dhe 2, neni 9 pika 1.1/b, neni 24 pika 1.2, të ligjit nr.22/2018 datë 03.05.2018 “Për strehimin social” të ndryshuar, neni 40, 41, 42, 43, të VKM Nr.454 datë 03.07.2019 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese”, të Vendimit të Këshillit të Bashkisë Vlorë Nr.100, datë 23.12.2025 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Vlorë për vitin 2026“, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Drejtoria e infrastrukturës dhe Investimeve Publike dhe Vendimin e Komisionit të Strehimit të Bashkisë;

VENDOSI

- I. Të miratojë deklaratën për bashkëfinancim drejtuar Drejtorisë së Strehimit pranë Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, për programin “Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara”, në projektin “Përmirësimi i kushteve të banesave ekzistuese”.
- II. Të miratojë deklaratën për financimin e projekteve të përmirësimit të kushteve të 21 banesave ekzistuese për vitin 2026 në vlerën totale = 31,846,675.37 lekë;
- në masën 50% të koston së projektit nga buxheti i Bashkisë Vlorë = 15,923,337.685 lekë
- në masën 50% të koston së projektit = 15,923,337.685 lekë kërkohet bashkëfinancim nga buxheti i shtetit.
- III. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike dhe Drejtoria e Financës pranë Bashkisë Vlorë.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr.139/2015 date 17.12.2015, neni 55, pika 6.

KRYETAR

Brunilda Mersini





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
DREJTORIA E INFRASTRUKTURËS DHE INVESTIMEVE PUBLIKE

Nr. 5707 prot.

Vlorë, më 24.03.2026

Lënda: Deklaratë për bashkëfinansim për projektin “Përmirësimi i kushteve të banesave ekzistuese”.

DREJTORISË SË STREHIMIT
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT

Tiranë

Mbështetur në shkresën Nr.628/2prot., datë 23.01.2026 “Mbi fondet për programet e strehimit 2026” të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, regjistruar pranë Bashkisë Vlorë me Nr.1880 prot., datë 28.01.2026, Bashkia Vlorë aplikon për mbështetje buxhetore sipas ligjit nr.22/2018, datë 03.05.2018 “Për strehimin social” të ndryshuar, në programin “Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara” në projektin “Përmirësimi i kushteve të banesave ekzistuese”.

Në këtë projekt për vitin 2026 janë përfshirë 25 familje/individë nga shtresat në nevojë që banojnë në 21 banesa të ndryshme të ndodhura në fshatrat pjesë e Njësisë Administrative të Bashkisë së Vlorës, konkretisht në Njësinë Administrative Qendër, 2 banesa, Njësinë Administrative Orikum 1 banesë, në Njësinë Administrative Shushicë 18 banesa.

Në buxhetin e vitit 2026 të miratuar me Vendimin e Këshillit të Bashkisë Vlorë Nr.100, datë 23.12.2025 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Vlorë për vitin 2026“ në zërin e investimeve është parashikuar shuma prej 16.000.000 lekë për projektet e përmirësimit të kushteve të banesave ekzistuese të komuniteteve të varfëra dhe të pafavorizuara.

Nisur nga tabela nr.2 për kufijtë e financimit në varësi të nivelit të të ardhurave për frymë sipas tabelës nr.1 „Niveli i të ardhurave vjetore për frymë për çdo bashki për vitin 2024“, Bashkia Vlorë duhet të financojë deri në 50% të koston totale të projektit.

Deri në 50% të koston totale të projekteve do të kërkojë për bashkëfinansim nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit.

-Kostoja totale për përmirësimin e kushteve të 21 banesave ekzistuese është = 31,846,675.37.00 lekë.

-Bashkia Vlorë deklaron se do të financojë vlerën = 15,923,337.685lekë.

-Kërkon nga buxheti i shtetit të bashkëfinancojë vlerën = 15,923,337.685 lekë.

Kjo deklaratë, ku pasqyrohet se Bashkia Vlorë do të financojë 50% të kostos totale për riparimin e 21 banesave në vlerën = 15,923,337.685 lekë, duke kërkuar nga fondet e buxhetit të shtetit bashkëfinancim deri në 50% të kostos totale të projekteve në vlerën = 15,923,337.685 lekë do të paraqitet për miratim në Këshillin e Bashkisë Vlorë në mbledhjen e radhës. Mbas miratimit do të dërgojmë kopje të Vendimit të Këshillit të Bashkisë pranë ministrit të suaj.

KRYETAR

Brunilda Mersini





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
DREJTORIA E INFRASTRUKTURËS DHE INVESTIMEVE PUBLIKE

Nr. 5707/2 prot.

Vlorë, më 24.03.2026

RELACION

Për projektvendimin

PËR MIRATIMIN E DEKLARATËS PËR BASHKËFINANCIM DREJTUAR MINISTRISË SË EKONOMISË DHE INOVACIONIT PËR “PROGRAMIN E PËRMIRËSIMIT TË KUSHTEVE TË BANIMIT PËR KOMUNITETE TË VARFËRA DHE TË PAFAVORIZUARA”.

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8 pika 1 dhe 2, neni 9 pika 1.1/b, neni 24 pika 1.2, të ligjit nr.22/2018 datë 03.05.2018 “Për strehimin social” të ndryshuar, neni 40, 41, 42, 43, të VKM Nr.454 datë 03.07.2019 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese”, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit me shkresën Nr.1880prot., datë 28.01.2026, “Mbi fondet për programet e strehimit për vitin 2026”, ka njoftuar të gjitha njësitë vendore mbi fondet e planifikuara për programet e strehimit për vitin 2026, duke i ftuar të aplikojnë për mbështetje buxhetore sipas ligjit nr.22/2018, datë 03.05.2018 “Për strehimin social”, të ndryshuar. Njoftimit për aplikim i bashkëlidhen “Termet e referencës për projektet e investimit që do të financohen nga buxheti i shtetit në vitet 2026-2027”, që parashikojnë;

1. Llojet e projekteve që do të financohen nga buxheti i shtetit dhe kufinj të financimit për familje,
2. Kushtet që duhet të plotësojë bashkia për t’u kualifikuar, formatin e aplikimit, dokumentacionin që do të hartohet për projektin, si dhe dokumentacionin që do të dorëzohet pranë ME&I për t’ju paraqitur Komisionit të Vlerësimit të Projekteve për shqyrtim dhe vlerësim (Dosja e aplikimit).

Pranë Bashkisë Vlorë përgjatë vitit 2025 janë regjistruar kërkesa nga familje/individë, të cilët disponojnë banesa të amortizuara në një ose më shumë pjesë të tyre, janë të papërshtatshme për banim të mëtejshëm, apo rrezikojnë jetën e banorëve nga mungesa e investimeve dhe e riparimeve ndër vite, për shkak të problematikave ekonomike dhe sociale të vazhdueshme. Po kështu janë depozituar shkresa nga njësitë administrative, Njësia Administrative Shushicë për riparimin e 18 banesave në fshatrat Risili, Grabian, Mekat, Drithas, Shushicë, Njësia Administrative Orikum me shkresën për rikonstruksionin 1 banese në fshatin Dukat dhe nga Njësia Administrative Qendër për riparimin e 2 banesave të ndodhura në fshatin Babicë e Madhe.

Pra në projektet e përmirësimit të kushteve të banesave ekzistuese për vitin 2026 janë përfshirë 21 banesa me vendndodhje;

- 18 banesa në Nj.A. Shushicë,
- 1 banesë në Nj.A. Orikum,
- 2 banesa në Nj.A. Qendër.

Grupi i punës i ngritur me Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë Vlorë Nr. 113, datë 03.02.2026 kanë shkuar në të gjitha banesat, kanë evidentuar pjesët e amortizuara të tyre dhe në marrëveshje me familjarët kanë përcaktuar ndërhyrjet dhe punimet më të domosdoshme që duhen kryer për përmirësimin e banesave të mbështetur në kufinj të financimit sipas termave të referencës me shkresën e ardhur nga ministria që mbulon strehimin. Në çdo banesë krahas matjeve planimetrike të nevojshme për të hartuar projekt-preventivat, janë bërë foto të pjesëve të dëmtuara të banesës në prani të familjarëve, të cilat do të jenë pjesë e dosjes së aplikimit që do të paraqitet pranë ministrisë.

Komisioni i Strehimit të Bashkisë Vlorë i mbledhur në datën 13.03.2026 mori në shqyrtim rezultatet e projekt-preventivave të hartuara për përmirësimin e 21 banesave, kostot për punimet e parashikuara sipas termave të referencës dhe kufinj të financimit për çdo banesë në projektin e riparimit të kushteve fizike të banesave ekzistuese, si edhe vlerën e parashikuar në buxhetin e Bashkisë Vlorë për vitin 2026 në zërin e investimeve për këto projekte. U konkludua se;

Për përmirësimin e kushteve të 21 banesave ekzistuese për 25 familje/individë, shuma totale e vlerave të të gjithë preventivave është = 31,846,675.37 lekë me tvsh.

Ministria në Termat e Referencës ka përcaktuar edhe përqindjen e bashkëfinancimit që i takon të financojë çdo bashki nga buxheti i saj sipas pikës 7 të Udhëzimit të Ministrit nr.31, datë 18.11.2019, sipas nivelit të të ardhurave vjetore për frymë për çdo bashki për vitin 2024 të përcaktuar me tabelë.

Nisur nga tabela nr.2 për kufijtë e financimit sipas tabelës nr.1 „Niveli i të ardhurave vjetore për frymë për çdo bashki për vitin 2024“, Bashkia Vlorë duhet të financojë deri në 50% të kostos totale të projektit.

Komisioni përcaktoi se, Bashkia Vlorë duhet të financojë 50% të kostos totale të projektit për përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese = 15,923,337.685 lekë.

Deri në 50% të kostos totale të projektit = 15,923,337.685 lekë do të kërkojë për bashkëfinancim nga buxheti i shtetit nëpërmjet Drejtorisë së Strehimit pranë Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit.

Pra, Bashkia Vlorë deklaron se do të financojë vlerën prej 15,923,337.685 lekë të kostos së projekteve.

Kërkon nga buxheti i shtetit për bashkëfinancim vlerën 15,923,337.685 = lekë.

Deklarata për financim nga buxheti i Bashkisë Vlorë me vlerat përkatëse dhe kërkesa për bashkëfinancim nga buxheti i shtetit me vlerat përkatëse, duhet të miratohen në parim nga Këshilli i Bashkisë Vlorë dhe të përcillen pranë ME&I si pjesë e dosjes së aplikimit.

Sa më lart, është hartuar ky projekt-vendim i paraqitur për miratim të këtij këshilli.

KRYETAR
Brunilda Mersini





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
KOMISIONI I STREHIMIT

Nr. 5707/1 /prot.

Vlorë, më 24 03 .2026

MIRATOHEJ
KRYETAR

Brunilda Mfersini

VENDIM

Nr. 6, datë 13.03.2026

Për miratimin e deklaratës për bashkëfinancim drejtuar Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit “Për programin përmirësimit të kushteve të banimit për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara”.

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8 pika 1 dhe 2, neni 9 pika 1.1/b, neni 24 pika 1.2, të ligjit nr.22/2018 datë 03.05.2018 “Për strehimin social” të ndryshuar, neni 40, 41, 42, 43, të VKM Nr.454 datë 03.07.2019 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese”, të shkresës së ME&I Nr.1080 prot., datë 28.01.2026, “Mbi fondet për programet e strehimit për vitin 2026”, Komisioni i Strehimit të Bashkisë i mbledhur në datën 13.03.2026, pasi shqyrtoi kostot për punimet e parashikuara sipas Termave të Referencës dhe kufinj të lejuar të financimit për çdo banesë në projektin e riparimit të kushteve fizike të banesave ekzistuese, vlerën e parashikuar në buxhetin e Bashkisë Vlorë për vitin 2026 në zërin e investimeve, si edhe vlerat e preventivave për të gjitha banesat e parashikuara për rikonstruksion për këtë vit,

KONSTATOI SE:

Në buxhetin e Bashkisë Vlorë për vitin 2026 të miratuar me Vendimin e Këshillit të Bashkisë Vlorë Nr.100, datë 23.12.2025 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Vlorë për vitin 2026” në zërin e investimeve është parashikuar shuma prej 16.000.000 lekë për projektet e përmirësimit të kushteve të banesave ekzistuese të komuniteteve të varfëra dhe të pafavorizuara.

Kostoja totale për përmirësimin e kushteve të 21 banesave ekzistuese të komuniteteve të varfëra dhe të pafavorizuara për vitin 2026, sipas projekt-preventivave të hartuara nga grupi i punës i ngritur me Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë Vlorë Nr.113, datë 03.02.2026 “Mbi ngritjen e grupeve të punës për hartimin e projekteve dhe preventivave në zbatim të projektit “Përmirësimi i kushteve të banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara”” është = 32,000,000.00 lekë me tvsh.

Nisur nga tabela nr.2 për kufinj të financimit sipas tabelës nr.1 „Niveli i të ardhurave vjetore për frymë për çdo bashki për vitin 2024“, Bashkia Vlorë duhet të financojë deri në 50% të kostos totale të projektit.

Sa më lart komisioni

V E N D O S I

1. Nisur nga Termat e Referencës të përcjella nga ministria bashkëfinancuese e projektit me shkresën Nr.10180 prot., datë 28.01.2026, “Mbi fondet për programet e strehimit për vitin 2026”, tabela nr.2 për kufinj të financimit sipas tabelës nr.1 „Niveli i të ardhurave vjetore për frymë për çdo bashki për vitin 2024“, Bashkia Vlorë duhet të financojë deri në 50% të kostos totale të projektit.
2. Duke qenë se kostoja totale e preventivave për rikostruksionin e 21 banesave ekzistuese të komuniteteve të varfëra dhe të pafavorizuara është = 32,000,000.00 lekë, Bashkia Vlorë duhet të financojë 50% të kësaj vlere = 16,000,000.00 lekë.
3. Deri në 50% të kostos totale të projektit = 16,000,000.00 lekë do të kërkojë për bashkëfinancim nga buxheti i shtetit nëpërmjet Drejtorisë së Strehimit pranë Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit.
4. Pra, Bashkia Vlorë deklaron se do të financojë vlerën prej 16,000,000.00 lekë të kostos së projekteve.
5. Kërkon nga buxheti i shtetit për bashkëfinancim vlerën = 16,000,000.00 lekë.
6. Lidhur me deklaratën për vlerën e financimit që merr përsipër të mbulojë Bashkia Vlorë dhe vlerën për bashkëfinancim që kërkohet nga buxheti i shtetit do të përgatitet projektvendimi që do të përcillet për të miratuar në Këshillin e Bashkisë. Vendimi i miratuar do të përcillet ministrisë si kusht i vendosur për kualifikim, pjesë e dokumentacionit që përmban dosja e aplikimit.

KOMISIONI:

1. Irena Toshkallari
2. Kristaq Jorgaqi
3. Mirela Mishgjoni
4. Skerdilajd Hunda
5. Orest Ruçaj
6. Elidon Jaho
7. Donald Leskaj
8. Bledar Toja
9. Genard Fegaj
10. Kanan Shakaj
11. Birçe Aliraj
12. Drini Harizaj
13. Drita Mustafai

Kryetar
anëtar
anëtar
anëtar
anëtar
anëtar
anëtar
anëtar
anëtar
anëtar
anëtar
anëtar
anëtar

